



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.1694/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kids Galaxy” SH.P.K., me NUI: 811281089, me seli në Zonën Industriale, rr. “Elez Berisha” nr. 31 në Prishtinë, të përfaqësuar sipas autorizimit nga Ardi Sheholli, kundër të paditurit Ministria e Financave - Komisioni i Ankesave, me seli në Prishtinë, të përfaqësuar nga Fatlum Xhaçkaj nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike: anulim i aktit administrativ – përkatësisht anulimi i Vendimit Nr.82/2020 të datës 11.08.2020, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.559/22 të datës 15.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit Ministria e Financave - Komisioni i Ankesave, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.559/22 i datës 15.07.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

1. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së parë”), me Aktgjykimin KA.nr.559/22 të datës 15.07.2024, (tani e tutje: “aktgjykimi i ankimuar”): me pikën I të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Kids Galaxy” SH.P.K., me seli në Prishtinë, (tani e tutje: “paditësi”), kundër të paditurit Ministria e Financave - Komisioni i Ankesave, me seli në Prishtinë, (tani e tutje: “i padituri”), për anulimin e Vendimit Nr.82/2020 të datës 11.08.2020 të të paditurit, (tani e tutje: “akti i kontestuar administrativ”); dhe me pikën II të dispozitivit ka udhëzuar paditësin që në procedurë kontestimore ta realizojë kërkesën e tij për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit.
2. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë i padituri për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, (tani e tutje: “Gjykata e shkallës së dytë”): të aprovojë si të bazuar ankesën

e paditësit; të prishë aktgjykimin e ankimuar; dhe të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

3. Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.
4. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi ligjshmërinë e çështjes juridike administrative në kuptim të nenit 12 të Ligjit Nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të LPK-së të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës vlerësoi se:
 - Ankesa është e pabazuar.
5. Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi pranë Gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës fillestare Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, për inicimin e konfliktit administrativ, me kërkesë për anulimin e aktit të kontestuar administrativ. Mirëpo, paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.03.2024 ka bërë ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv duke deklaruar si palë të paditur vetëm të paditurin Ministria e Financave – Komisioni i Ankesave, me seli në Prishtinë. Paditësi gjithashtu ka kërkuar që të detyrohet i padituri që t'ia rimburojë paditësit pagesën për dy qira sipas masës 3b të pakos emergjente fiskale në lartësi prej 25,578.71 € me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive. Paditësi në padi ka pretenduar se me datë 16.04.2020 ka aplikuar për subvencionimin e qirasë për periudhën mars dhe prill të vitit 2020, por që sipas masës 3b pagesa bëhet në muajin prill dhe maj të vitit 2020, paditësi duke e ditur se nga data 13.03.2020 i është pezulluar veprimtaria dhe duke rënë në vështirësi ekzistenciale të funksionimit të veprimtarisë fillestare të tij, e duke e parë faktin se veprimtaria është pezulluar, me qëllim për të përfituar nga masa 3b sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente Covid-19 për shkak të rrethanave të krijuara nga kriza e pandemisë. Sipas tij, i padituri përmes Komisionit të Përbashkët të Administratës Tatimore të Kosovës me datë 01.07.2020 përmes Vendimit 01 – Masa 3b ka refuzuar kërkesën me arsyetim se nuk janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara sipas planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, konkretisht se për muajt para muajit mars paditësi nuk ka deklaruar për tatim në qira apo ka deklaruar me zero. Paditësi ka shtuar se ka parashtruar ankesë administrative me datë 17.07.2020, të cilën ankesë i padituri përmes aktit të kontestuar administrativ e ka refuzuar si të pabazuar me arsyetim se paditësi nuk ka përmbushur kushtet e kërkuara sipas masës 3b të pakos emergjente fiskale. Sipas paditësit, akti i kontestuar administrativ i të paditurit nuk është i bazuar në ligj dhe për më tepër dispozitivi i tij bije ndesh me arsyetimin, sepse fare nuk jepen arsytet për faktet vendimtare të cilat i ka shqyrtuar i padituri. Më tutje, paditësi ka pretenduar se nuk është fare kontestuese se me datë 25.09.2019 është pajtuar dhe e ka nënshkruar kontratën e qirasë me qiradhënësin, sipas nenit 3 pika 3.4 të së cilës shihet qartë se palët janë pajtuar që pagesa e qirasë të fillojë të paguhet nga data 01.03.2020, meqë qiramarrësi ka qenë i obliguar të bëjë investime në objektin e marrë me qira dhe se në marrëveshjen me qiradhënësin 3 muaj nga fillimi i hapjes së veprimtarisë së qiramarrësit nuk do të paguhet qiraja për shkak të investimeve që ka bërë qiramarrësi, rrjedhimisht i ka plotësuar pikat e parapara me Vendimin me Nr.31-2/2020 të datës 27.04.2020

pika 4, nën-pika 4.2, si dhe qiradhënësi ka faturuar dhe deklaruar qiratë ndaj paditësit për muajtë mars 2020 dhe prill 2020.

6. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative, si gjykatë e shkallës së parë, pasi ka administruar provat e propozuara, mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pasi ka vlerësuar çështjen juridike administrative, në Aktgjykimin e saj KA.nr.559/22 të datës 15.07.2024, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit për anulimin e aktit të kontestuar administrativ të të paditurit është e bazuar.
7. Gjykata e shkallës së parë pasi ka bërë vlerësimin e provave të administruara, pretendimeve të palëve dhe shkresat e tjera të lëndës në këtë konflikt administrativ, ndër të tjera, ka ardhur në konstatimet si në vijim:
 - 7.1. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se me datë 25.09.2019 paditësi si qiramarrës kishte lidhur kontratën e qirasë me qiradhënësin “BD ESTATE” SH.P.K., me seli në Prishtinë. Objekt i kësaj kontrata kishte qenë marrja me qira për 10 vite e tre lokaleve: lokali i parë në sipërfaqe prej 2893.92 m²; lokali i dytë në sipërfaqe prej 216.11 m²; dhe lokali i tretë në sipërfaqe prej 175.50 m². Të gjithë lokalet gjenden në katin e parë, në kompleksin afarist Avior në rr. “Elez Berisha”, zona industriale në Prishtinë. Gjithashtu, sipas nenit 3 të kontratës, hapësira e marrë me qira ka qenë e lirë për shfrytëzim nga data 01.10.2019, në të cilën paditësi është dashur që të investojë, ndërsa palët janë pajtuar që tre muajtë e parë nga data 01.12.2019 qiramarrësi nuk do të paguaj qira për tre muaj. Po ashtu, Gjykata e shkallës së parë gjeti se nuk ka qenë kontestuese mes palëve se kjo kontratë ishte e ngarkuar në EDI të ATK-së në ditën e aplikimit;
 - 7.2. Nga i padituri nuk ka qenë i ngritur asnjë pretendim se paditësi nuk i kishte plotësuar kushtet tjera për të përfituar nga Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente Covid-19;
 - 7.3. Lidhur me gjendjen faktike, Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i padituri atë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë kur ka konstatuar se paditësi e kishte deklaruar me zero tatimin në qira për periudhën kohore para muajit mars 2020;
 - 7.4. Megjithatë, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se i padituri i ka zbatuar gabimisht dispozitat materiale kur e ka refuzuar kërkesën e paditësit. Lidhur me të drejtën material Gjykata e shkallës së parë ka rikujtuar se fillimisht Qeveria e Kosovës përmes pikës 1 të Vendimit Nr.01/19 të datës 30.03.2020 e kishte aprovuar pakon emergjente, ndërsa me pikën 2 e kishte autorizuar Ministrinë e Financave që për masat e nevojshme të parapara me pakon emergjente fiskale të nxjerrë vendim për të përcaktuar kriteret, afatet, kushtet, mënyrën e zbatimi si dhe të gjitha specifikat tjera të nevojshme për zbatimin e tyre, sipas parimit të menaxhimit të financave publike. Në këtë frymë, ministria e sapocekur i kishte përcaktuar kriteret për përkrahjen financiare për pakon emergjente me Vendimin Nr.31/2020 të datës 03.04.2020, me të cilin e kishte aprovuar Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente. Ky vendim ishte ndryshuar përmes Vendimit Nr.31-1/2020 të datës 27.04.2020 dhe Vendimit Nr.31-3/2020 të datës 22.05.2020. Nga kriteret e përcaktuara përmes këtyre vendimeve, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se deklarimi në ATK i tatimit në

qira ose mosdeklarimi me zero i tatimit në qira nuk ishte paraparë shprehimisht si kriter për përkrahjen financiare sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente;

- 7.5. Për këtë arsye, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se as nga akti i kontestuar administrativ, e as nga shkresa e lëndës, nuk është vërtetuar se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet tjera të parapara me planin e cekur më lart;
- 7.6. Më tutje, Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se meqenëse në rastin konkret i padituri e ka refuzuar kërkesën e paditësit në bazë të kritereve që nuk kanë qenë të parapara me Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, atëherë i padituri e ka shkelur ligjin material, rrjedhimisht ka vepruar në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë dhe pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme. Kjo për faktin se paditësi si parashtrues i kërkesës për kompensimin e qirasë ka pasur pritje legjitime që vetëm kriteret e përcaktuara me Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente do të merren për bazë gjatë shqyrtimit të kërkesës së tij; dhe
- 7.7. Për në fund, në lidhje me kërkesën e paditësit për rimbursimin e dy qirave sipas Planit Operacional të Pakos Fiskale Emergjente, Gjykata e shkallës së parë në bazë të nenit 46, para. 5 të LKA-së ka gjetur se të dhënat e procedurës nuk japin për këtë gjë bazë të sigurtë, meqenëse sipas pikës 5 të masës 3b të Planit Operacional të Pakos Fiskale Emergjente (ndryshimi i fundit) *“Pagesat e subvencionimit të qirasë do t’i paguhet në xhirollogarinë bankare të qiradhënësit për dy muaj”*, ndërsa Gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur prova se janë plotësuar kushtet nga pika 6 e planit të cekur më lart. Kjo për Gjykatën e shkallës së parë ka nënkuptuar se shuma e të hollave të njohura për subvencionim sipas Planit Operacional të Pakos Fiskale Emergjente është dashur t’i paguhet qiradhënësit e jo qiramarrësit. Duke marrë parasysh se në rastin konkret palë në këtë procedurë është vetëm qiramarrësi (paditësi), atëherë Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se të dhënat e procedurës nuk japin bazë të sigurtë për vendosur meritorisht lidhur me kërkesën për shpërblimin e dëmit, dhe rrjedhimisht e ka udhëzuar paditësin për këtë kompensim monetar në procedurë kontestimore.
8. Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerësoi se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi: aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së; me aktgjykimin e ankimuar është bërë konstatimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike; dhe se është bërë zbatimi i saktë i së drejtës materiale.
9. Gjykata e shkallës së dytë sa i përket pretendimeve ankimore të të paditurit në lidhje me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale gjeti se:
 - 9.1. Aktgjykimi i ankimuar nuk përbënë shkelje të nenit 182, para. 2, pika n) të LPK-së, sepse ai nuk përmbanë asnjë të metë të paraparë në këtë dispozitë ligjore. Aktgjykimi i ankimuar mund të ekzaminohet, dhe ka një dispozitiv më se të kuptueshëm që nuk është në kontradiktë me vetveten. Krahas këtyre, aktgjykimi i ankimuar përmbanë arsyetime të qarta më se të mjaftueshme për

faktet vendimtare. Për më tepër, sa i përket përmbajtjes së shkresave të lëndës në përgjithësi nuk ekzistojnë kundërthënie në mes të arsyetimit të aktgjykimit të ankimuar dhe vetë shkresave të lëndës. Prandaj, Gjykata e shkallës së dytë konstatoi se ky pretendim ankimor i të paditurit paraqet pretendim ankimor të pabazuar; dhe

- 9.2. Më tutje, Gjykata e shkallës së dytë duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së, i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore të paditësit në lidhje me shkeljet e dispozitave procedurale nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, mirëpo Gjykata e shkallës së dytë vlerësoi se këto pretendime ankimore të të paditurit fare nuk kanë mbështetje ligjore dhe argumentim të qëndrueshëm. Si të tilla këto pretendime ankimore të të paditurit nuk kanë relevancë juridike dhe paraqesin pretendime ankimore të pabazuara.
10. Kolegji i kësaj gjykate në lidhje me pretendimet ankimore të të paditurit për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike erdhi në përfundim se këto pretendime ankimore fare nuk kanë bazë ligjore dhe argumentim të qëndrueshëm. Si të tilla, Kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi këto pretendime ankimore të të paditurit si pretendime të pabazuara. Për më tepër, Kolegji i kësaj gjykate gjeti se Gjykata e shkallës së parë duke i vlerësuar drejtë dhe saktë provat në këtë çështje juridike administrative, ka bërë konstatimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike për këtë çështje juridike administrative, dhe si të tillë Kolegji i kësaj gjykate në tërësi pranon gjendjen faktike të konstatuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje juridike administrative.
11. Gjykata ankimore në lidhje me pretendimet ankimore të të paditurit sa i përket shkeljeve të së drejtës materiale erdhi në konstatimet si në vijim:
- 11.1. Me parashtrimin e këtyre pretendimeve ankimore për shkeljen e së drejtës materiale nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, i padituri në përgjithësi nuk ka bërë saktësimin e dispozitave juridiko-materiale të pretenduara për shkelje me aktgjykimin e ankimuar. Megjithatë, Gjykata ankimore *ex officio* në kuptim të nenit 194 të LPK-së ka analizuar zbatimin e së drejtës materiale nga ana e Gjykatës së shkallës së parë për këtë çështje juridike administrative. Si rrjedhojë e shqyrtimeve të bëra Gjykata ankimore gjeti se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të saktë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë në këtë konflikt administrativ;
- 11.1.1. Neni 194 i LPK-së thekson: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji”.
- 11.2. Në këtë drejtim, sikurse vlerësuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë, Gjykata ankimore konstatoi se i padituri në cilësinë e organit administrativ në procedurë administrative duke aluduar apo shtuar një kriter shtesë, përkatësisht paraqitjen e të dhënave tatimore, në kriteret për sigurimin e mbështetjes financiare nga pakoja emergjente në fjalë, ka bërë shkelje të parimit të ligjshmërisë në procedurë administrative në kuptim të nenit 4 të LPPA-së. Ndërsa, ndryshimi i

kritereve apo shtimi i tyre në ndërkohë pa mëdyshje ka ndikuar negativisht në pritshmërinë legjitime dhe të arsyeshme të paditësit në procedurë administrative në kuptim të nenit 8, para. 1 të LPPA-së.

11.2.1. Neni 4 i LPPA-së thekson: “1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj ...”.

11.2.2. Neni 8, para. 1 i LPPA-së thekson: “Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave”.

11.3. Në këtë drejtim, Gjykata e shkallës së parë fillimisht në mënyrë të saktë ka konstatuar se çka ka paraqitur të drejtë materiale për të paditurin në cilësinë e organit administrativ për të vendosur për këtë çështje juridike administrative në procedurë administrative – që në rastin përkatës e drejta materiale për këtë çështje juridike administrative paraqet përmbajtjen definitive të Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente lidhur me masën 3b, në të cilën përmbajtje janë renditur në mënyrë takstative kriteret për fitimin e kësaj mbështetje financiare. Mëpastaj, Gjykata e shkallës së parë me saktësi ka cilësuar aktin e kontestuar administrativ si të kundërligjshëm – kundërligjshmëria e të cilit mbi të gjitha buron nga zbatimi i gabuar i kësaj të drejte materiale nga ana e të paditurit në cilësinë e organit administrativ në procedurë administrative. Si rrjedhojë e kësaj, Gjykata e shkallës së dytë gjeti se e drejta materiale për këtë çështje juridike administrative apo thënë më saktë kriteret e sapopërmendura, kanë qenë të formuluar në frymën e parimit të enumeracionit pozitiv. Këtu për qëllime të qartësimit duhet theksuar se parimi i enumeracionit pozitiv paraqet një parim juridik përmes të cilit në rastin konkret janë renditur në mënyrë takstative kriteret e nevojshme që duhen plotësuar për sigurimin e mbështetjes financiare nga pakoja emergjente në fjalë. Këtu duhet shtuar se vetë renditja e kritereve në mënyrë takstative ka paraqitur një indikacion të qartë dhe të fuqishëm si për aplikuesit për sigurimin e mbështetjes financiare nga pakoja emergjente në fjalë – në këtë rast për paditësin, si dhe për të paditurin që ka pasur për detyrim që në cilësinë e organit administrativ në procedurë administrative të bëjë vlerësimet dhe zbatimet e nevojshme të këtyre kritereve. Për më tepër, duhet pasur parasysh se renditja në mënyrë takstative e kritereve në fjalë, në frymën e parimit të enumeracionit pozitiv mbi të gjitha ka ofruar një siguri juridike, qartësi ligjore, dhe parashikim apo pritshmëri legjitime dhe të arsyeshme për subjektet aplikuese, përfshirë këtu paditësin. Ndërsa, anashkalimi i këtij parimi, apo thënë më drejtë vendosja e kriterit shtesë në mënyrë të papajtueshme me ligjshmërinë e plotësim-ndryshimeve të akteve juridike, përfshirë këtu edhe thirrjet, nga ana e të paditurit në cilësinë e organit administrativ kualifikohet si veprim kundërligjor dhe arbitrar që pakontestueshmërisht ka shkelur parimin e ligjshmërisë dhe parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në procedurë administrative;

11.4. Megjithatë, duhet të mirret parasysh fakti se Kolegji i kësaj gjykate, duke e cilësuar kërkimin e mëpastajmë të të dhënave përkatëse tatimore apo me përmbajtje të caktuar të tyre në kuadër të aplikimit të paditësit për sigurimin e mbështetjes financiare nga pakoja emergjente në fjalë si

veprim të kundërligjshëm të të paditurit – që ka pasur efekt retroaktiv negativ tek paditësi, Kolegji i kësaj gjykate assesi nuk e konteston apo vë në mëdyshje rëndësinë që këto të dhëna tatimore mund të kishin pasur për vlerësimin e drejtë dhe të saktë të aplikantëve meritore. Megjithatë, Kolegji i kësaj gjykate konsatoti se mosvendosja e këtij kriteri që në fillim apo brenda afatit kohor të arsyeshëm për thirrjen për mbështetje financiare paraqet lëshim të vetë organit administrativ.

- 11.5. Në bazë të vlerësimeve të mësipërme, Gjykata ankimore erdhi në përfundim se Gjykata e shkallës së parë përmes vlerësimit të saj të dhënë me aktgjykimin e ankimuar ka zbatuar saktë të drejtën materiale lidhur me këtë çështje juridike administrative.
12. Si përfundim duke u bazuar në të lartcekurat, Dhomat e Shkallës së Dytë konstatuan se Gjykata e shkallës së parë pasi ka zhvilluar dhe përfunduar një konflikt administrativ në pajtim me dispozitat procedurale të parapara me LKA dhe LPK, dhe pasi ka bërë konstatimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike bazuar në shkresat e lëndës, e njëjta ka dhënë qëndrimin e saj të saktë përmes nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar në përputhje të plotë me të drejtën materiale.
13. Nga sa u tha më lart, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë gjeti se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje të konfliktit administrativ, prandaj në mbështetje të nenit 195, para. 1, pika (d), dhe nenit 200 të LPK-së të ndërlidhur me nenin 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1694/24 datë 27.11.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova